1. Zot Gafur Dudaj, ka 81 755 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 01 deri në numrin e serisë 81 755.
2. Zoti Dritan Mustafa, ka 100 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 81 756 deri në numrin e serisë 81 855.



Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht pastaj shpërndahen ndërmjet ortakëve sipas ndarjes së mësipërme.

Neni 9

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, me rrugë trashëgimie, në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen të tretëve vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 2/3 e pjesëve dhe me kushte jo më të favorshme se ato me të cilat ju janë ofruar më parë ortakëve të tjerë.

K R E U III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 10

Ortakët dhe Asambleja e Ortakëve

Ortakët e Shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Në ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga një person tjetër i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblesë mund të kërkohet nga një ose disa ortakë që zotërojnë mbi 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tillë ose nga likujduesit. Mbledhja e asamblesë do të thirret nga administratori.

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e Asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarja e fitimit etj. Asambleja e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera etj.

Asambleja e zakonshme në mbledhjen e parë mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm ose të përfaqësuar një numër ortakësh që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar dhe vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar të pranishëm ose të përfaqësuar. Në qoftë se mbledhja e parë e Asamblesë së zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të



vlefshme, pavarësisht se sa pjesë të kapitalit themeltar zotërojnë ortakët e pranishëm ose të përfaqësuar dhe vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Asambleja e jashtëzakonshme kërkon kushte prezencë ose përfaqësimi të njëjtë me ato të Asamblesë së zakonshme si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë, por vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 11 Administrimi

Shoqëria administrohet nga një administrator që duhet të jetë person fizik dhe mund të jetë ortak në shoqëri ose jo.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar. Emërimi i tij bëhet për një kohëzgjatje të barabartë me periudhën e ekzistencës së vetë shoqërisë.

Administratori i vetëm i kësaj Shoqërie është zoti **Gafur Dudaj**, i biri i Farhatit, lindur në Vlore, më 1938, banues në rrugën "Sami Frasheri" nr. 41. Tirane.

Në marrëdhënie me ortakët dhe të tretët administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ua japin shprehimisht ortakëve.

Neni 12 Ekspertët kontabël të autorizuar

Në rast nevojë ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi rrizgjedhje nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

K R E U IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 13 Viti financiar, llogaritë vjetore

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja, me vendimin e ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 14 Dividentët

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5 % e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

K R E U V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 15 Prishja

Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij Statuti, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 15 ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara me ligj.

Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paafte ose vdes.

Neni 16 Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likujdues, i cili i paraqet asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit Asambleja vendos, me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar.

K R E U VI

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 17 Shndërrimi i shoqërisë





Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve, ndërsa shndërrimi në shoqëri anonime, me miratimin e ortakëve që zotërojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 18 Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 20

Ky Statut është hartuar më 24.06.2002, në Tiranë, në katër kopje në origjinal, në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha tekstet fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKËT

Gafur DUDAJ

Dritan MUSTAFA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1542 REP.
Nr. 187 Kol

VERTETIM

Sot, ne datën 25.06.2002, përpara meje noterit publik Vangjel Daka, në zyrën time të ndodhur pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tiranë, u paraqiten personalisht Zoti Dritan Mustafa, i biri i Ganiut, lindur në Tiranë më 1968 dhe banues në rrugën "Mihal Grameno" Pall.87, shk.1 Ap.6 me kombësi dhe shtetësi shqiptarë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, administrator i shoqërisë "DUDA KONSTRUKSION" shpk me pasaportë me numër 1544353, dhe zoti Gafur Dudaj, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur në Vlorë më 1939, banues në Tiranë në rrugën "Sami Frasherit", me shtetësi dhe kombësi shqiptarë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me letërnjoftim nr. UG Nr.018152, të cilet me deklaron se STATUTI i mesipër është redaktuar në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan atë rregullisht përpara meje. Une, Noteri, e vertetoj atë sipas ligjit.

NOTERI
VANGJEL DAKA





STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “DUDAJ KONSTRUKSION” Sh.P.K.

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar “DUDAJ KONSTRUKSION” shpk eshte rregjistruar me vendimin me Nr. 25297, date 18.10.2001 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Kjo shoqeri eshte bashkuar me shoqerine “DUDA” shpk me vendimin e Gjykates me Nr. 8466/4, date 05.07.2002. Me vendimin Nr. 8466/7, date 16.07.2004 eshte miratuar projekti i ndarjes se shoqerise “DUDAJ KONSTRUKSION” shpk nga shoqeria “DUDA” shpk. Une i nenshkruari, **Gafur Duda**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur me 1939, ne Vlore, banues ne Tirane, adresa Rr. “Sami Frasheri” Nr. 41, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, Ortak i Vetem dhe Administrator i Shoqerise “Duda” shpk, sot me daten 21 Shtator 2004, miratoj statutin e ri te shoqerise “DUDAJ KONSTRUKSION” shpk.

KAPITULLI I

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1

Emri

Shoqeria do te vazhdoje te kete emertimin “DUDAJ KONSTRUKSION” shpk, e cila më poshtë do te quhet “Shoqëria”, me ortak te vetem zotin Gafur Dudaj.

Neni 2

Forma

Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqërisë është ne Tirane, në rrugen “Hamdi Pepa” prane tregut ushqimor Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

Neni 4

Territori

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.



Shoqëria mund të krijojë dege, filiale ose perfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II

OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5 Objekti

Shoqëria "DUDAJ KONSTRKSION" shpk do të vazhdojë të ketë si objekt të veprimtarisë së saj :

Per projektim:

Kat. 1/e – planvendosje objektësh të vacanta.

Kat. 3/a – projektim i strukturave të zakonshme Iprij murature tulle, guri, betoni,b/armeje dhe metalike.

Kat 6 – a,c.

Kat. 7/a – projektim vepra arti të vogla

Per zbatim

Kat.1 – punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh.

Kat.2 – a,c.

Kat.3 – ndertime civile dhe ekonomike

Kat.4/a – ndertim rruge kat. V,IV.

b – ndertim rruge kat. III,II,I

c – veshje me asfaltbeton të rrugëve (ndertim mbishtrese) si dhe sistmim dhe asfaltim sheshe.

Kat 5/a – ndertime hekurudhore

b – punime speciale të shinave dhe binareve

Kat.6 – a,b – ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore.

Kat.8/a – ndertim diga, galeri, tunele, dmada etj.

Kat.9/a – sillosa, kulla, kulla uji, ejt, prej b/armeje

b - sillosa, kulla, kulla uji,metalike

c – themele të veçanta

Kat.10/a – rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash.

Kat.11 – punime karpantjerie

Prodhim dhe tregatim materiale ndertimi

Transport mallrsh dhe pasagjeresh.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.



KAPITULLI III

AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE, KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Fusha e autoritetit te ortakut

Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

Neni 8

Libri i Shoqerise

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 9

Konfidencialiteti

Ortaku i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 10

Dokumentet e destinuarra per te tretet

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuarra për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE

Neni 11


Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë do te jete 100.000 (njëqindmijë) lekë. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 12

Kontributet

Kapitali themeltar zoterohet 100% nga ortaku i vetem i shoqerise Gafur DUDAJ



Neni 13 **Pjeset e kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera, me vlerë 1.000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

Neni 14 **Tranferimi i pjeseve te kapitalit**

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortakut i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkeshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të behen ortak nepermjet transferimit të pjeseve të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen në ligj.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial.

KAPITULLI V

STRUKTURA,ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 15 **Asambleja e Ortakeve**

Si organ i vetëm drejtues i Shoqerise është Asambleja e Ortakeve, (Ortakut i Vetëm), me iniciativën dhe kapitalin e të cilit vepron Shoqeria.

Neni 16 **Kompetencat**

Për sa kohë që Shoqeria do të përbehet nga një ortak i vetëm, kompetencat e e tij do të jenë:

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqerise dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqerine apo për sektore të veçante të veprimtarisë.

Vendos për politiken afariste të Shoqerise dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.

Emeron dhe shkarkon administratoret e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre të përcaktuara në Statut.

Kur e shikon të nevojshme emeron drejtorin ekzekutiv të Shoqerise apo të sektoreve të veçante të saj, duke caktuar në aktin e emerimit edhe kompetencat e tij, kohezgjatjen në punë etj..

Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive

Vendos për krijimin e degeve (filialeve) ose të perfaqësive si dhe për krijimin e shoqerive me persona të tjerë fizike apo juridike.

Vendos për mbarimin e Shoqerise, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqerise nga shoqeri me përgjegjësi të kufizuar në shoqeri të formave të tjera.



Realizon marrëdhëniet me të rendesishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizike apo juridike, vendas apo të huaj.

Vendos çmimet e shitjes, të shërbimeve etj..

Vendos për pagat e të punësuarve në Shoqëri.

Përveç kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzive për të, Ortaku i Vetëm, në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë Statut janë përcaktuar për këtë të fundit.

Neni 17

Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit në mënyrë konkrete dhe të detajuara përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

Kujdeset për funksionimin e përditshëm normal të Shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.

Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet Ortakut të Vetëm për shqyrtim.

Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri

Shqyrtton ofertat dhe përgatit kërkesa të cilat i paraqet për miratim.

Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore, me personat e tjerë.

Perfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretet

Emërimi i administratorit do të bëhet për një afat të përcaktuar

Administratori i shoqërisë është caktuar Besnik Dudaj

KAPITULLI VI

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

Neni 18

Librat e Shoqërisë

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

Neni 19

Bilanci

Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.



Neni 20 Dividentet

Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ai percakton fitimin e vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per: rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortaku; fondet e tjera qe shihen te nevojeshme dhe, nga ana tjetere i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Keshtu ortaku i vetem percakton dhe dividentin.

KAPITULLI VII

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 21 Mbarimi

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 22 Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

KAPITULLI VII


MOSMARRËVESHJEVE DHE DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 24 Dispozita te fundit


Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.



Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohen nga Ortaku i vetem.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETEM
Gafur DUDAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 4736 Rep.
Nr - Kol.

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën ~~22~~20/09/2004 perpara meje, Noterit publik u paraqit personalisht z. **Gafur Duda**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur me 1939, ne Vlore, banues ne Tirane, adresa Rr. "Sami Frasheri" Nr. 41, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi te plote per te vepruar, me leternjoftim nr. UG 018152, ortak i vetem i shoqerise "DUDA"Shpk. Personi i mësipërm është madhore, me zotësi të plotë për të vepruar dhe i njohur personalisht prej meje. Pasi unë, Noteri, ia lexova dhe ia shpjegova Statutin, bashkëngjitur këtij vërtetimi, ai më deklaroi se e kupton, e pranon dhe se e ka hartuar atë në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë. Pasi e nënshkroi perpara meje rregullisht, unë e vërtetoj kete gje sipas ligjit.

NOTERI





DEKLARATË NOTERIALE

Ne Tirane, sot me date 27.10.2006 (Njezet e shtate, Tetor, dymije e gjashte), perpara meje Noterit Publik, Vangjel DAKA, Antar i Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Blv. "Gjergj Fishta", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane u paraqit personalisht shtetasia:

Hazbie LEKA, e bija e Nazmiut, e datelindjes 1960, banuese ne Tirane, ne adresen, Rruga "Tre Vellezerit Kondi", Eksperte Kontabel e Miratuar, me licence me Nr. 118 dhe me kod fiskal K32122008K, i cila ne cilesine e porositeses kerkoi perpilimin e deklarates noteriale si me poshte:

"Raporti i ekspertit te kontributeve te shoqerise "DUDA" Shpk, date 18.10.2006 bashkelidhur kesaj deklarate eshte pregatitur dhe nenshkruar prej meje. Ky raport eshte perpiluar pasi me vendimin me Nr. 01 date 11.07.2006 Ortaku i Vetem i shoqerise "DUDA" Shpk, ka vendosur shtimin e kapitalit te shoqerise "DUDA" Shpk duke me caktuar mua ne cilesine e ekspertit kontabel per pregatitjen e raportit per kete qellim. Ky vendim eshte miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin e saj me Nr. 8466/9, date 02.10.2006.


Ne pergjegjesine time te plote ligjore, Une deklaroj qe ne permbushjen e detyres se mesiperme nuk kam patur asnje pengese ligjore dhe per kryerjen e saj nuk kam patur konflikt interesash. Gjithashtu deklaroj se raporti eshte perpiluar bazuar ne bilancin e shoqerise, ne materialet e tjera ndihmese, ne verifikimet e nevojshme per kete qellim dhe ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar".


Une, noteri, ia lexova deklaraten e mesiperme me ze te larte deklarueses, dhe pasi ajo me deklaroi se eshte shkruar drejt, ne perputhje te plote me vullnetin e saj te lire, e nenshkroi ate ne pranine time. Une noteri vertetoj vullnetin e saj sipas ligjit.

DEKLARUESE
Hazbie LEKA

Hazbie Leke

Eksp Kontabel Autorizuar
HAZBIJE LEKA
Nr Lic





VENDIM
Nr. 02 date 24.10.2006

I Ortakut te Vetem te Shoqërisë "DUDA" shpk.

Sot, në Tiranë, më datën 24.10.2006 (Njezet e kater, Tetor, dymije e gjashte), në selinë e shoqërisë "DUDA" Shpk, Ortaku i Vetem i saj Z. Gafur DUDAJ, pasi u njoh dhe mori ne shqyrtim raportin e ekspertit te kontributeve Znj. Hazbie LEKA, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqërisë "DUDA" shpk, perpiluar me date 18.10.2006, Ortaku i Vetem ne perputhje me statutin e shoqërisë dhe me ligjin me Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare":

VENDOSI:


1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve Znj. Hazbie LEKA, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqërisë "DUDA" shpk, perpiluar me date 18.10.2006.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqërisë ne vleren 146 936 383 leke.
3. Pasqyrimin e ndryshimeve te mesiperme edhe ne statutin e shoqërisë duke pasqyruar se kapitali themeltar i shoqërisë "DUDA" shpk eshte 228 691 383 leke, i cili zoterohet ne masen 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqërisë nga Ortaku i Vetem i shoqërisë "DUDA" Shpk, Z. Gafur Dudaj.
4. Vlera nominale e nje pjese te kapitalit themeltar te shoqërisë eshte 2 286 914 leke.
5. Per kryerjen e te gjithë procedures ligjore ne lidhje me depozitimn e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ngarkohet Administratori i shoqërisë Z. Gafur DUDAJ dhe Av. Xhevahir HOXHA.
6. Ky vendim perpilohet ne gjuhen shqipe, ne kater kopje te gjitha me fuqi te barabarte.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "DUDA" SHPK

Gafur DUDAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4487 Rep. Nr. 2288 Kol.

U APLIKUA PUBLIKU PAKSES




VERTETIM

Not, në Tiranë, në datën 25.10.2006 (Njezet e pese, Tetor, dymije e gjashte), perpara meje, Noterit Publik Vangjel DAKA, me seli ne Tirane, ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqit personalisht shtetasi:

Gafur DUDAJ, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me date 25.01.1939, banues ne Tirane, ne adresen, Rr. "Sami Frasheri", Nr. 41, me shtetesi shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar nga dokumenti i identifikimit pasaporte me Nr. Z0891998,

I cili me cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Sh.p.k., me deklaroi se **Vendimi me Nr. 02 date 24.10.2006 i Ortakut te Vetem te shoqerise "DUDA" Shpk**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, eshte i hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë, dhe e nënshkroi rregullisht perpara meje, gjë të cilën, unë noter i vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI
Vangjel DAKA



3. E. Baga
25.10.2006
25
VETEM
2006



K Ë R K E S Ë

KËRKUES: **Gafur DUDAJ**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore date 25.01.1939, banues ne Tirane, ne adresen, Rr. "Sami Frasheri", Nr. 41, me shtetesi shqiptare, madhor dhe me zotesi per te vepruar, administrator i shoqerise "DUDA" shpk.

OBJEKTI: Depozitimi ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit te Ortaku te Vetem te Shoqerise "DUDA" Shpk me Nr. 02 date 24.10.2006.

BAZA LIGJORE: Ligji me Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PERPARA: **GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR,**
TIRANE

Enderua zonja Gjyqtare!
Shoqeria "DUDA" Shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me Nr. 8466, date 08.12.1993. Shoqeria "DUDA" shpk ka nje kapital prej 81 355 000 lekesh dhe zoterohet ne 100% te pjeseve nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise Z. Gafur Dudaj, Shoqeria e ka seline ne Rrugen "Sami Frasheri" Nr. 41, Tirane.

Me vendimin e tij me Nr. 02, date 24.10.2006, Ortaku i Vetem i shoqerise "DUDA" Shpk, ka vendosur;

1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributive Znj. Hazbie LEKA, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "DUDA" shpk, perpiluar me date 18.10.2006.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "DUDA" Shpk ne vleren 158 229 133 leke, nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartuara, te paraqitura ne llogarite vjetore te vitit 2005.
3. Pasqyrimin e ndryshimeve te mesiperme edhe ne statutin e shoqerise duke pasqyruar se kapitali themeltar i shoqerise "DUDA" shpk eshte 240 084 133 leke, i cili zoterohet ne masen 100% te pjeseve nga Ortaku i Vetem i shoqerise "DUDA" Shpk, Z. Gafur DUDAJ.

Per kryerjen e te gjithe procedures ligjore ne lidhje me depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane jam ngarkuar Une administratori i shoqerise dhe Av. Xhevahir HOXHA.

Per kete arsye dhe bazuar ne Ligjin me Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjin me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" i kerkoj Gjykates Tuaj te Nderuar depozitim ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit me Nr. 02, date date 24.10.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Shpk.

Ne pritje te caktimit te seances gjyqesore!

Me Respekt Kerkuesi
Gafur DUDAJ

Gafur Duda
Kerkesa

REPublika e SHqIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4443 Rep. Nr. 220 Kol

UAPLIKES DALLI E TAKSES


VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 24.10.2006 (Dymije e gjashte), perpara meje, Noterit Publik Vangjel DAKA, me seli ne Tirane, ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqit personalisht shtetasi:

Gafur DUDAJ, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me date 25.01.1939, banues ne Tirane, ne adresen, Rr. "Sami Frasheri", Nr. 41, me shtetesi shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar nga dokumenti i identifikimit pasaporte me Nr. Z0891998,

I cili me cilesine e administratorit shoqerise "DUDA" Sh.p.k, me deklaroi se **kerkesa e administratorit te shoqerise "DUDA" Shpk**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, eshte i hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë, dhe e nënshkroi rregullisht perpara meje, gjë të cilën, unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI
Vangjel DAKA



K Ë R K E S Ë

KËRKUES: **Gafur DUDAJ**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore date 25.01.1939, banues ne Tirane, ne adresen, Rr. "Sami Frasheri", Nr. 41, me shtetesi shqiptare, madhor dhe me zotesi per te vepruar, administrator i shoqerise "DUDA" shpk.

OBJEKTI: Depozitimi ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Shpk me Nr. 02 date 24.10.2006.

BAZA LIGJORE: Ligji me Nr. 7638 , dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PERPARA:

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

E nderuar zonja Gjyqtare!

Shoqeria "DUDA" Shpk eshte rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me Nr. 8466, date 08.12.1993. Shoqeria "DUDA" shpk ka nje kapital prej 81 755 000 lekesh dhe zoterohet ne 100% te pjeseve nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise Z. Gafur Dudaj. Shoqeria e ka seline ne Rruget "Sami Frasheri" Nr. 41, Tirane.

Me vendimin e tij me Nr. 02, date 24.10.2006, Ortaku i Vetem i shoqerise "DUDA" Shpk, ka vendosur;

Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve Znj. Hazbie LEKA, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "DUDA" shpk, perpiluar me date 18.10.2006. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 146 936 383 leke. Pasqyrimin e ndryshimeve te mesiperme edhe ne statutin e shoqerise duke pasqyruar se kapitali themeltar i shoqerise "DUDA" shpk eshte 228 691 383 leke, i cili zoterohet ne masen 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise nga Ortaku i Vetem i shoqerise "DUDA" Shpk, Z. Gafur Dudaj. Vlera nominale e nje pjese te kapitalit themeltar te shoqerise eshte 2 286 914 leke.

Per kryerjen e te gjitha procedures ligjore ne lidhje me depozitimin e ketij vendimi ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane jam ngarkuar Une administratori i shoqerise dhe Av. Xhevahir HOXHA.

Per kete arsye dhe bazuar ne Ligjin me Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjin me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" i kerkoj Gjykates Tuaj te Nderuar depozitimin


ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit me Nr. 02, date date 24.10.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Shpk.

Ne pritje te caktimit te seances gjyqesore!



Me Respekt Kerkuesi
Gafur DUDAJ

Gafur Duda
Emri i Kompani: Firma e Gafur Duda Sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4443 Rep. Nr. 2269 Kol

U APLIKUA RREGULLA E TAKSES



VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 24.10.2006 (Njzet e kater, Tetor, dymije e gjashte), perpara meje, Noterit Publik Vangjel DAKA, me seli ne Tirane, ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, u paraqit personalisht shtetasi:

Gafur DUDAJ, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me date 25.01.1939, banues ne Tirane, ne adresen, Rr. "Sami Frasheri", Nr. 41, me shtetesi shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar nga dokumenti i identifikimit pasaporte me Nr. Z0891998,

I cili me cilesine e administratorit shoqerise "DUDA" Sh.p.k, me deklaroi se **kerkesa e administratorit te shoqerise "DUDA" Shpk**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, eshte i hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë, dhe e nënshkroi rregullisht perpara meje, gjë të cilën, unë noterit e vërtetoj sipas ligjit.



22.07.2006
22.08.2006
22 SHTATOR 2006

K Ë R K E S Ë

KËRKUES: Gafur DUDAJ, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me 1939, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me shtetesi shqiptare, banues ne Rrugen "Sami Frasheri", Nr. 41, Tirane, administrator i shoqerise "DUDA" shpk.

OBJEKTI: Depozitimi i akteve te shoqerise "DUDA" shpk, vendimit me nr. 01 date 11.07.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise. *(Te depozitimit shkruar)*

BAZA LIGJORE: Ligji me Nr. 7638 , dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PARA

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

11.7.2006
Ortakut
11.7.2006
Ortakut
11.7.2006
Ortakut

E nderuar zonja Gjyqtare!
Me vendimin e saj me Nr. 8466, date 08.12.1993, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka rregjistruar ne regjistrin tregtar te kesaj Gjykate, Shoqerine "DUDA" shpk! Shoqeria "DUDA" shpk ka nje kapital prej 81 855 000 lekesh dhe zoterohet ne 100% te pjeseve nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise Z. Gafur Dudaj. Shoqeria e ka seline ne Rrugen "Sami Frasheri" Nr. 41, Tirane.

Me vendimin me Nr.01 date 11.07.2006, Ortaku i vetem shoqerise "DUDA" shpk ka vendosur: Te shtoje kapitalin e shoqerise dhe te emeroje ne cilesine e eksperies kontabel te miratuar per pergatitjen e raportit te znj. Hazbie Leka, me licence me Nr. 118.

Per kete arsye dhe bazuar ne Ligjin me Nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjin me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" kerkoj depozitimin ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane te vendimit me Nr. 01, date date 11.07.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Shpk.

Ne pritje te caktimit te seances gjyqesore!

KERKUESI
Gafur DUDAJ

Gafur Dudaj
[Signature]


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 6936 Rep. Nr. — Kol

U APLIKUA PULLA E TAKSES

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 14 .09.2006, para meje, Noterit Publik, **Mira M. VUKAJ** antare i Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne adresen, Rr. "Mihal Grameno" u paraqit personalisht shtetasi, **Gafur Dudaj**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me 1939, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, banues ne Rrugen "Sami Frasheri" Tirane, i identifikuar nga pasaporta me Nr. Z0891998, me cilesine e administratorit dhe ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Sh.p.k, i cili deklaroi se **Kerkesen** bashkelidhur ketij vertetimi e ka hartuar vete ne perputhje te plotë me vullnetin e tij të lirë dhe e nënshkroi ate para meje rregullisht, gjë të cilën, unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI
Mira M. VUKAJ





V E N D I M Nr.01/2006

I Ortakut te Vetem te Shoqërisë "DUDA" shpk.

Sot, në Tiranë, më datën 11.07.2006, Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "DUDA" sh.p.k shqyrtoi pasqyrat financiare dhe rezultatin financiar te shoqerise, pasi vendosi per terheqjen e nje pjese te fitimit ne formen e dividendit

V E N D O S I :

1. Te shtoje kapitalin themeltar te shoqerise me shumat qe rezultojne si kontribut i ortakeve te Shoqerise "DUDA" Sh.p.k. si dhe shumat qe rezultojne ne postin e primeve te lidhura me kapitalin ne pasiv te bilancit te shoqerise.


2. Të emeroje znj. Hazbie Leka, e bija e Nazmiut, lindur me 1960, me adrese ne Rrugen "Tre vellezerit Kondi", ne cilesine e Ekspertes Kontabel te Miratuar, me licence me Nr. 118 dhe me kod fiskal K32122008K per te pergatitur raportin e auditimit per shtimin e kapitalit te shoqerise.

3. Të autorizojë per ndjekur procedurat e depozitimit te ketyre akteve ne rregjistrin tregtar Av. Mirash Martini dhe Av. Xhevahir Hoxha per te perfaqesuar shoqerine ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

4. Ky vendim perpilohet ne gjuhen shqipe, ne kater kopje te gjitha me fuqi te barabarte.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "DUDA" SHPK


Gafur DUDA-J



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 2901 Rep. Nr. 1829 Kol.

V E R T E T I M

Sot, në Tiranë, në datën 11.07.2006, perpara meje, Noterit u paraqit personalisht zoti: zoti Gafur Dudaj, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur ne Vlore me 1939, madhor dhe me zotesi per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, banues ne Rrugen "Sami Frasheri" Tirane, i njohur personalisht prej meje, me cilesine e ortakut te Vetem te Shoqerise "DUDA" Sh.p.k., i cili me deklaroi se **Vendimin e shoqerise**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, ata e kanë hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë, dhe e nënshkroi para meje rregullisht perpara meje, gjë të cilën, unë e vërtetoj sipas ligjit.



A U T O R I Z I M

Une Gafur DUDAJ, Ortaku i Vetem dhe Administrator i Shoqerise "DUDA" shpk, me vendimin e dates 11.07.2006 kam vendosur te shtoj kapitalin e shoqerise dhe te emerroje ne cilesine e ekspertes kontabel te miratuar, znj. Hazbie Leka per te pergatitur raportin e auditimit lidhur me kete.

Për të perfaqësuar mua dhe shoqerine "DUDA" shpk përpara Gjykatave Shqiptare lidhur me kerkesat per depozitime aktesh ne Gjykate, bazuar ne statutin e shoqerise une autorizoj avokatët: Av.Mirash Martini, dhe Av. Xhevahir Hoxha, të dy antarë të Dhomës së Avokatëve Tiranë, respektivisht me Nr. liçence 1239 dhe 1920.

Avokatët kanë të drejtë veçmas ose të dy se bashku të përpilojnë, të nënshkruajnë kërkesa, qe lidhen ne depozitimim e akteve te ndryshme te shoqerise ne rregjistrin tregtar, te perfaqesojne shoqerine ne seancat qe zhvillohen lidhur procedurat e marrjes se vendimit, te paraqesin akte te shoqerine per shqyrtim dhe ti depozitojne ato ne rregjistrin tregtar.


Avokatet kanë të drejtë të kerkojne, te marrin edhe kopje te akteve te shoqerise dhe esktrakte te tyre ne Rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Përveç sa është shprehur në këtë autorizim avokatët kanë edhe të gjitha te drejtat që legjislacioni civil i nje perfaqësuesit.


Të gjitha veprimet e kryera nga avokatët unë i konsideroj të mireqëna sikur t'i kisha kryer vetë.

ADMINISTRATORI
Gafur DUDAJ

Gafur Dudaj



RAPORTI I EKSPERTIT TE NDARJES DHE I KONTRIBUTEVE



Me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr.8466/7 dt.16.07.2004, jam caktuar te kryej misionin e ekspertit per operacionin e ndarjes se shoqerise tregtare "DUDA" sh.p.k, e cila do te kontriboje me pjese te aktivitetit te saj ne formimin e shoqerise se re, te quajtur "DUDAJ KONSTRUKSION" sh.p.k .

Per operacionin e ndarjes, drejtimi i shoqerise "DUDA" sh.p.k, ka hartuar projektin e ndarjes. Ne kete projekt eshte parashikuar qe shoqeria "DUDA" sh.p.k do te kontriboje me pjese te aktivitetit te saj ne vleren 100.000 leke per krijimin e shoqerise se re "DUDAJ KONSTRUKSION" sh.p.k.Per kontributin e marre shoqeria "DUDAJ KONSTRUKSION" sh.p.k, si shoqeri perfituese, do ti jape ortakut te vetem te shoqerise "DUDA" sh.p.k, z. Gafur DUDAJ, 100 pjese te kapitalit themeltar te saj, me vlere nominale 1000 leke per pjese.Edhe ne shoqerine e re "DUDAJ KONSTRUKSION" sh.p.k. z. Gafur DUDAJ do te jete ortaku i vetem i shoqerise.Kontributi pjesor me aktive eshte parashikuar te behet ne formen e elementeve te vecante te aktiveve, pa detyrime ndaj te treteve.E gjithë shuma qe do te transferohet do te jete ne vlere monetare.

Ne permbushje te misionit ne kemi verifikuar bilancin e shoqerise "DUDA" sh.p.k te dates 01.01.2004, i cili eshte marre si baze e ndarje ne projektin e hartuar.Nga verifikimet qe ne kryem vertetohet se oganizimi administrativ dhe kontabel i shoqerise eshte i pershtatshem per te krijuar dokumenta financiare te besueshme.Vleresimi i aktiveve dhe pasiveve, te paraqitura ne bilanc, eshte ne pershtatje me standartet kontabile dhe per opinionin tone vleresimi analitik i tyre, perafrohet me vlerat e tregut.Nga shqyrtimi i projektit ne kostatuam se elementet qe perfshihen ne ndarje perputhen me inventarin fizik dhe kontabel te momentit ndares dhe aktiviteti qe eshte transferuar eshte pjese e ketij inventari.Te drejtat ne kapitalin themeltar ne shoqerine perfituese, te fituara nga ortakut i vetem i shoqerise kontribuuese eshte proporcional me aktivitetin e transferuar.Metoda e perdorur per realizimin e ndarjes vleresohet e drejte.

Konkluzioni i raportit

Sipas mendimit tone, projekti i ndarjes qe na eshte paraqitur, eshte hartuar me kriteret e pershtateshme, vleresimi i elementeve te aktivitetit qe transferohen eshte i drejte dhe te drejtat e fituara nga ortakut i shoqerise se re eshte proporcional me aktivitetin e transferuar.

Mbas kryerjes se operacionit te ndarjes kapitali themeltar i shoqerise "DUDA" sh.p.k eshte 81 755 000 leke dhe kapitali themeltar i shoqerise "DUDAJ KONSTRUKSION" sh.p.k eshte 100 000 leke.

Ky mision eshte kryer konform normave profesionale per vleresime te tilla.

EKSPERTI I NDARJES

Bujar OSMANI

Ekspert kontabel i autorizuar

Ekspert Kontable.

BUJAR OSMANI

Tel.339 46

Tirana me, 15.09.2004

REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE


Nr 4656 Rep.

Nr = Kol.

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 20/09/2004 perpara meje, Noterit publik u paraqit personalisht z. **Bujar Osmani**, i biri i Maliqit, lindur me 1965, ne Tirane, banues ne Tirane, adresa Rr. "Sami Frasheri" Pall.13 Ap.4 Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me licence "Expert kontabel i miratuar" me Nr. 70, i cili me deklaroi se "**Raportin e ekspertit te ndarjes dhe i kontributeve**" bashkëngjitur këtij vërtetimi, ai e ka hartuar ne perputhje te plote me normat profesionale per vleresime te tilla dhe pasi e nënshkroi perpara meje rregullisht, unë e vërtetoj kete gje sipas ligjit.

NOTERI

A handwritten signature in black ink is written over a circular notary stamp. The stamp contains some illegible text and a central emblem.



V E N D I M
Nr. 06, date. 20.09.2004

Ortakut te Vetem te Shoqërisë "DUDA" shpk.

Sot, në Tiranë, më datën 20.09.2004, Ortaku i Vetem dhe Administrator i Shoqërisë "DUDA" Shpk, z. Gafur Dudaj pasi shqyrtoi raportin e ekspertit kontabel Bujar Osmani për ndarjen e shoqërisë në dy shoqëri të reja të së njëjtes forme bazuar në Statutin e Shoqërisë dhe në Ligjin me Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", në Ligjin me Nr. 7667, datë 28.01.1993 :Për rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare

V E N D O S I :

1. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel Bujar Osmani hartuar me datën 15.09.2004 për ndarjen e shoqërive.

2. Ndarjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DUDA" do ndahet me pasoje krijimin e dy shoqërive të tjera të së njëjtes forme, pra me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

a - Dy shoqëritë e krijuara nga ndarja do të kenë emertimet **"DUDA" Shpk** dhe **"DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk**.

b - Ortak te Vetem dhe Administrator i shoqërisë "DUDA" Shpk do të jete z. **Gafur Dudaj**, ndërsa shoqëria "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk do të kete ortak te vetem me 100% të kapitalit themeltar z. **Gafur Dudaj** dhe administrator z. **Besnik Dudaj**.

c - Selite e reja të shoqërive do të jene: Shoqëria "DUDA" Shpk në Rr **"Sami Frasheri" Nr. 41, Tirane**. Shoqëria "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk në Rruga **"Hamdi Pepa" pranë tregut Ushqimor**.

d - Kapitali themeltar i shoqërisë "DUDA" shpk është **81 755 000** (tetedhjeteenjemilioneshtateqindepesedhjeteepesemije) leke, ndërsa kapitali themeltar i shoqërisë "DUDAJ KONSTRUKSION" shpk është **100 000** (Njeqindmije) leke.

e - Objekti i veprimtarisë së shoqërive nuk ndryshonështë në përputhje me objektin e tyre.

4. Ngarkohet administratori i shoqërisë Z. Gafur Duda të paraqese kërkesën pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me qëllim që të bëhet depozitimi i akteve dhe ndryshimet e duhura në Regjistrin Tregtar.

5. Keto ndryshime do të pasqyrohen në statutet e dy shoqërive, "DUDA" shpk dhe "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk.


Ky vendim përpilohet në gjuhën shqipe, në katër kopje të gjitha me fuqi të barabartë.

**ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATORI I "DUDA" SHPK
GAFUR DUDAJ**

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 20/09/2004 përpara meje, Noterit publik u paraqit personalisht z. **Gafur Duda**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur me 1939, ne Vlore, banues ne Tirane, adresa Rr. "Sami Frasheri" Nr. 41, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi te plote per te vepruar, me leternjoftim nr. UG 018152, ortak i vetem i shoqerise "DUDA" Shpk. Personi i mësipërm është madhore, me zotësi të plotë për të vepruar dhe i njohur personalisht prej meje. Pasi unë, Noteri, ia lexova dhe ia shpjegova, **Vendimin**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, ai më deklaroi se e kupton, e pranon dhe se e ka hartuar atë në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë. Pasi e nënshkroi përpara meje rregullisht, unë e vërtetoj kete gje sipas ligjit.

NOTERI





VENDIM
Nr. 02. Date. 23.09.2004

Ortakut te Vetem te Shoqërisë "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk

Sot, në Tiranë, më datën 23.09.2004, Ortaku i Vetem dhe Administrator i Shoqerise "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk, z. Gafur Duda pasi shqyrtoi Statutin e e ri te Shoqerise, bazuar ne Ligjin me Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", ne Ligjin me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSI:

1. Miratimin e e statutit te ri te shoqerise (*bashkelidhur ketij vendimi*).
2. Ngarkohet administratori i shoqerise Z. Gafur Duda të paraqese kërkesen pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me qëllim që të bëhet depozitimi i akteve dhe ndryshimet e duhura në Regjistrin Tregtar.

Ky vendim perpilohet ne gjuhen shqipe, ne kater kopje te gjitha me fuqi te barabarte.

**ORTAKU I VETEM DHE ADMINISTRATORI I "DUDAJ KONSTRUKSION"
Shpk**

GAFUR DUDAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 1742 Rep.

VERTE TIM

Sot, në Tiranë, në datën 22/09/2004 perpara meje, Noterit publik u paraqit personalisht z. Gafur Duda, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur me 1939, ne Vlore, banues ne Tirane, adresa Rr. "Sami Frasheri" Nr. 41, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me leternjoftim nr. UG 018152, ortak i vetem i shoqerise "DUDAJ KONSTRUKSION" Shpk. Personi i mësipërm është madhore, me zotësi të plotë për të vepruar dhe i njohur personalisht prej meje. Pasi unë, Noteri, ia lexova dhe ia shpjegova, **Vendimin**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, ai më deklaroi se e kupton, e pranon dhe se e ka hartuar atë në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë. Pasi e nënshkroi perpara meje rregullisht, unë e vërtetoj kete gje sipas ligjit.

NOTERI



84668

KËRKESË

B Mucog
20 SHKATOR 2004

KËRKUES:

Z. **Gafur Duda**, i biri i Ferhatit dhe i Fetijes, lindur me 1939, ne Vlore, banues ne Tirane, adresa Rr. "Sami Frasheri" Nr. 41, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, administrator dhe ortak i vetem i shoqerise "DUDA" shpk.
Depozitimi i vendimit me Nr.06, date 20.07.2004.

OBJEKTI:

BAZA LIGJORE: Ligji me Nr. 7638 , dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji me Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

PARA

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

Me vendimin e saj me Nr. 8466, date 08.12.1993, Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka regjistruar ne regjistrin tregtar te kesaj Gjykate, Shoqerine "DUDA" shpk. Shoqeria "DUDA" shpk ka nje kapital prej 81 855 000 lekesh dhe zoterohet ne 100% te pjeseve nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise Z. Gafur Duda. Shoqeria ka seline ne Rrugen "Sami Frasheri" Nr. 41, Tirane. Me vendimin e saj me Nr. 8466/6 date 16.07.2004, Gjykata ka vendosur te depozitoje vendimin me Nr. 05, date 14.07.2004 te Ortakut te vetem te shoqerise qe miraton projektin per ndarjen e kesaj shoqerine ne dy shoqeri: "DUDA" Shpk. dhe "DUDAJ KONSTRUKSION" shpk si dhe ka caktuar ekspertin kontabel Bujar Osmani per kryerjen e ekspertimit lidhur me procedurat e ndarjes.

